

VENDIM
Nr.510, datë 13.5.2009

PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË KOMISIONIT TË MBROJTJES NGA RREZATIMET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 6 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, i cili të kryesohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe të ketë në përbërje:

- Një përfaqësues nga Instituti i Shëndetit Publik;
- Drejtorin e Drejtorisë Juridike, në Ministrinë e Shëndetësisë;
- Një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- Një ekspert të rrezatimeve jonizuese;
- Dy përfaqësues nga Universiteti i Tiranës, ekspertë të mbrojtjes nga rrezatimet;
- Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

2. Kryetari i zyrës së mbrojtjes nga rrezatimet është sekretar i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, ekspert të rrezatimeve jonizuese.

3. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMRR) është autoriteti kombëtar rregullator, i cili mbikëqyr dhe siguron zbatimin e ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese.

4. Komisioni mbledhet, si rregull, një herë në 2 muaj, sipas njoftimit të kryetarit dhe mbledhjet zhvillohen me jo më pak se 2/3 e anëtarëve. Njoftimi përmban rendin e ditës dhe materialet, që do të diskutohen në mbledhje. Ai u dërgohet anëtarëve të komisionit të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhje.

5. Mbledhja e parë e KMRR-së duhet të thirret jo më vonë se 45 ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe në këtë mbledhje zgjidhet protokolluesi i komisionit, i cili mban procesverbalin e mbledhjeve të KMRR-së.

6. Mbledhjet e KMR-së i drejton kryetari, dhe, në mungesë të tij, vetë kryetari cakton një anëtar të komisionit për drejtimin e mbledhjes.

7. Kur një anëtar nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi përjashtohet, me vendim të Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes, dhe zëvendësohet nga institucioni përkatës.

8. Mandati i anëtarëve të komisionit është 4-vjeçar.

9. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar dhe për sekretarin e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi, është 5000 (pesë mijë) lekë për çdo mbledhje.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

11. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha